

LIGJ
Nr.9665, datë 18.12.2006

PËR HUAMARRJEN SHTETËRORE, BORXHIN SHTETËROR DHE GARANCITË SHTETËRORE TË HUASË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

(ndryshuar me ligjin nr. 181/2014, datë 24.12.2014; me ligjin nr. 92/2022 , datë 22.12.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 156 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

Ky ligj synon të rregullojë emetimin dhe menaxhimin e huamarrjes shtetërore, të borxhit shtetëror dhe të garancive shtetërore të huasë.

Neni 2

Kuptimi i huamarrjes shtetërore

(ndryshuar me ligjin nr. 181/2014, datë 24.12.2014)

Huamarrja shtetërore është një veprimtari që realizohet nëpërmjet marrëveshjeve dhe instrumenteve, të cilat përmbajnë rregulla për të drejtat dhe detyrimet e palëve, kushtet dhe mënyrat, sipas të cilave shteti shqiptar siguron fonde nga një apo më shumë huadhënës dhe dispozita për shlyerjen e huave.

Neni 3

Kuptimi i garancisë shtetërore të huas

(ndryshuar me ligjin nr. 92/2022 , datë 22.12.2022)

Garancia shtetërore e huas është detyrimi për pagesën nga buxheti i shtetit të detyrimeve financiare të një personi juridik apo fizik, që lindin nga një marrëveshje huaje për të cilën Republika e Shqipërisë ose Këshilli i Ministrave ka dalë garant, në rast se pala, që mban përgjegjësinë kryesore për pagesën e detyrimit financiar, nuk ka arritur ta paguajë atë në kohën dhe masën e duhur.

Garancia shtetërore e huas dokumentohet nëpërmjet një marrëveshjeje të lidhur me shkrim, e cila përmban rregulla për të drejtat dhe detyrimet e palëve, kushtet dhe mënyrat, sipas të cilave shteti është përgjegjës për detyrimet financiare të një huamarrësi, kur ai nuk arrin t'i paguajë ato në kohën dhe masën e duhur.

Neni 4

Kuptimi i borxhit shtetëror

Borxh shtetëror është shuma e përgjithshme e borxhit të shtetit, e emetuar në monedhën kombëtare dhe/ose në një monedhë zyrtare të ndryshme nga monedha kombëtare, i cili nuk përfshin detyrimet financiare të bashkive/komunave apo të ndonjë autoriteti tjetër të pushtetit vendor. Borxhi shtetëror përfshin edhe borxhet e Republikës së Shqipërisë, të krijuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Për efekt të përlogaritjes së borxhit shtetëror, në rastin kur një detyrim i papaguar është emetuar në një monedhë të ndryshme nga monedha kombëtare, ai vlerësohet në monedhën kombëtare, sipas kursit zyrtar të këmbimit, të shpallur nga Banka e Shqipërisë, në çastin e vlerësimit.

Neni 5 Titujt e shtetit

Titujt e shtetit janë instrumentet e borxhit shtetëror, të emetuara me interes, me bazë zbritjeje apo të kombinuara, me interes dhe bazë zbritjeje, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga ministri përgjegjës për financat.

Neni 6 Menaxhimi i borxhit dhe raportimi i tij

(ndryshuar paragrafi i parë dhe shtuar paragraf pas paragrafit të dytë me ligjin nr. 181/2014, datë 24.12.2014; ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 92/2022, datë 22.12.2022)

Menaxhimi i borxhit është veprimtaria shtetërore, qëllimi kryesor i së cilës është sigurimi i fondeve të nevojshme të huamarrjes, duke vlerësuar riskun dhe koston e tij, në këndvështrimin afatmesëm dhe afatgjatë, si dhe zhvillimin e tregut të titujve të shtetit, nëpërmjet shtimit të instrumenteve të tij dhe zgjerimit të bazës së investitorëve.

Ministri përgjegjës për financat përgatit Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit dhe e paraqet atë për miratim në Këshillin e Ministrave. Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit vlerësohet dhe monitorohet rregullisht çdo vit nga ministri përgjegjës për financat. Ministri përgjegjës për financat harton një raport monitorimi të objektivave të vendosur në Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit dhe e dorëzon atë pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat, jo më vonë se tre muaj pas përfundimit të vitit. Raporti i monitorimit publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për financat. Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit rishikohet në rastet kur vlerësohet se kushtet e tregut të brendshëm dhe tregut të jashtëm financiar, si dhe treguesit makroekonomikë dhe fiskalë kanë ndryshuar duke u ndikuar nga ngjarje apo rrethana të jashtëzakonshme si katastrofa ose fatkeqësi natyrore, gjendje lufte, kriza financiare, si dhe ngjarje të cilat sjellin si rrjedhojë shmangie të parimeve dhe rregullave fiskale që lidhen me qëndrueshmërinë e borxhit. Pavarësisht rasteve të përmendura në këtë paragraf, Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit do të rishikohet jo më vonë se një vit përpara përfundimit të afatit të strategjisë në fuqi. Strategjia e rishikuar miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ministri përgjegjës për financat raporton çdo katër muaj në Kuvend, pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat, për ecurinë e borxhit shtetëror dhe borxhit të garantuar të shtetit.

Ministri përgjegjës për financat përgatit raportin vjetor për gjendjen e borxhit shtetëror, i cili miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe paraqitet në Kuvend, si pjesë përbërëse e raportit të realizimit të buxhetit të konsoliduar për vitin përkatës.

Neni 7 Qëllimi i marrjes së borxhit

(shtuar shkronja “e” me ligjin nr. 181/2014, datë 24.12.2014; shtuar fjalë me ligjin nr. 92/2022, datë

22.12.2022)

Ministri përgjegjës për financat, në emër Republikës së Shqipërisë ose të Këshillit të Ministrave, merr hua:

- a) për të financuar deficitin buxhetor të shtetit;
- b) për të financuar mungesën e përkohshme të likuiditetit;
- c) për të rifinancuar borxhin shtetëror, të nënshkruar më parë;
- ç) për të paguar garancitë shtetërore;
- d) për të paguar koston e emetimit të borxhit shtetëror;
- dh) për të përballuar koston e shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore dhe emergjenca të tjera.
- e) për të financuar nevojat e njëjësive të qeverisjes vendore dhe të subjekteve të tjera, për qëllim të financimit të projekteve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Neni 7/1

Qëllimi i lëshimit të garancisë shtetërore të huas

(shtuar me ligjin nr. 92/2022, datë 22.12.2022)

Ministri përgjegjës për financat, në emër të Republikës së Shqipërisë ose Këshillit të Ministrave, lëshon garanci shtetërore të huas:

- a) për të mbështetur politikat e Këshillit të Ministrave për zhvillimin e sektorëve të ekonomisë;
- b) për të mbështetur kreditimin e ndërmarrjeve shtetërore që veprojnë në sektorët kryesorë të sigurimit të shërbimeve dhe të mirave publike, me qëllim realizimin e projekteve të investimeve nga këto ndërmarrje;
- c) për të mbështetur kreditimin e ndërmarrjeve private në zbatim të politikave të veçanta të Këshillit të Ministrave, për të mbështetur sektorë të caktuar të ekonomisë. Në këtë rast mund të përdoren skema të veçanta kolektive të garancive shtetërore, të referuara si “skema të veçanta të garancisë”, ku ministri përgjegjës për financat lëshon një garanci me një vlerë të caktuar, në përfitim të një grupi apo kategorie të caktuar përfituesish dhe ku skema zbatohet nëpërmjet institucioneve financiare që ushtrojnë veprimtarinë e kredithënies në vend. Menaxhimi i këtyre skemave të veçanta të garancive, duke përfshirë, por pa u kufizuar në procesin administrativ që ka të bëjë me verifikimin e kushteve dhe kritereve të dhënies së kredive nga institucionet financiare, monitorimin e zbatimit të skemave, menaxhimin e dokumentacionit, mbikëqyrjen dhe ndjekjen e kthimit të garancisë, do të mundësohet nga një institucion i caktuar me ligj për kryerjen e këtyre funksioneve, referuar në këtë ligj si “institucioni i caktuar me ligj për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive”;
- ç) për të mbështetur masat që mund të ndërmerren në rastet e ndonjë krize të sistemit financiar;
- d) për të mbështetur ristrukturimin e portofolit ekzistues të garancive shtetërore të huas me qëllim reduktimin e nivelit të riskut.

Neni 8

Monedha për nënshkrimin, emetimin dhe pagesën e borxhit shtetëror

(zëvendësuar lidhëz me ligjin nr. 92/2022, datë 22.12.2022)

Borxhi shtetëror nënshkruhet, emetohet dhe paguhet në monedhë kombëtare ose në monedhë të huaj.

Neni 9

Kufizimet e borxhit shtetëror dhe të garancive shtetërore të huave

(ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 92/2022, datë 22.12.2022)

Kufizimet për shumën e borxhit shtetëror dhe për shumën e garancive shtetërore të huave përcaktohen në ligjin vjetor të buxhetit. Në ligjin vjetor të buxhetit vendoset kufiri për:

- a) borxhin e ri të qeverisjes qendrore për t'u marrë në vitin buxhetor;
- b) nivelin e borxhit të qeverisjes qendrore në fund të vitit;
- c) garancitë e reja për t'u lëshuar gjatë vitit buxhetor nga qeveria qendrore;
- ç) nivelin e garancive të qeverisjes qendrore në fund të vitit;
- d) borxhin e emetuar për të mbuluar humbjet e bankës qendrore nga rivlerësimi i valutave.

Ndryshimet në kursin e këmbimit valutor, pas emetimit të borxhit shtetëror apo pas emetimit të garancisë shtetërore të huasë, që shkaktojnë kapërcimin e kufizimeve të parashkruara ndaj shumës së papaguar të borxhit shtetëror apo garancisë shtetërore të huasë, nuk përbëjnë shkelje të ligjit.

Borxhi shtetëror, i emetuar për të përballuar koston e shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore dhe emergjencat të tjera, nuk i nënshtrohet kufizimit të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni. Çdo borxh shtetëror, i emetuar për këtë qëllim, do të përfshihet në përlogaritjen e borxhit shtetëror të papaguar, menjëherë pas emetimit të tij.

KREU II BORXHI I KONTRAKTUAR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 10

Autoriteti i borxhit shtetëror

Ministri përgjegjës për financat emeton titujt e shtetit, të cilat mund të jenë afatgjata ose afatshkurtra dhe hyn në negociata për marrëveshjet e huave shtetërore.

Neni 11

Statusi i parave të marra borxh

Fondet e mbledhura nëpërmjet huamarrjes klasifikohen si të hyra për qëllimet e financimit të deficitit buxhetor.

Neni 12

Dhënia e garancisë shtetërore të huasë

Garancia shtetërore e huasë u jepet institucioneve huadhënëse me miratimin e ministrit përgjegjës për financat.

Neni 13

Natyra e detyrimit të borxhit shtetëror

(shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 181/2014, datë 24.12.2014; shtuar fjalë në paragrafin e parë me ligjin nr. 92/2022, datë 22.12.2022)

Borxhi shtetëror përbën një detyrim absolut dhe pa kushte të shtetit. Shteti angazhohet dhe garanton plotësisht, në përputhje me kushtet e përcaktuara për titujt e shtetit dhe në marrëveshjet e huasë, pagimin në kohë të interesave detyrimeve të tjera dhe shlyerjen e principalit.

Tejkalimi i kufizimeve, të përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji, nuk mund të cenojë palët e treta (huadhënësit ose mbajtësit e titujve të shtetit, si dhe personat, në favor të të cilëve shteti ka dhënë garanci shtetërore) dhe në asnjë rast nuk sjell si pasojë pavlefshmërinë e marrëveshjeve përkatëse të huamarrjes apo lëshimit të garancive shtetërore.

Neni 14
Financimi i përhershëm

Në ligjin vjetor të buxhetit parashikohen fonde të mjaftueshme për pagesën e interesit dhe shlyerjen e principalit, për llogari të borxhit shtetëror. Ministri përgjegjës për financat, pasi përcakton se pagesa është e detyrueshme, autorizon derdhjen e menjëhershme të saj.

Neni 15
Përparësia e borxhit shtetëror

Të gjitha detyrimet, që përbëjnë borxh shtetëror, trajtohen në mënyrë të barabartë, pavarësisht nga koha kur janë krijuar dhe pavarësisht nëse janë në formën e titujve të shtetit apo të marrëveshjeve të huasë. Pagesa e principalit apo e interesit të borxhit shtetëror trajtohet me përparësi, në krahasim me pretendimet ndaj llogarisë së depozitës së përgjithshme të Këshillit të Ministrave. Këto pagesa janë parësore ndaj çdo pretendimi tjetër për pagesë nga depozita e lartpërmendur.

KREU III
TITUJT E SHTETIT

Neni 16
Autoriteti i emetimit

Ministri përgjegjës për financat emeton titujt e shtetit, në formën e regjistrimit në llogari apo në formë fizike. Ministri përgjegjës për financat autorizon krijimin e sistemit të regjistrimit kompjuterik për titujt e emetuar, në formën e regjistrimit në llogari, si dhe administrimin e këtij sistemi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një ndërmjetësi.

Neni 17
Gjendja e titujve të emetuar në llogari

Sistemi i regjistrimit në llogari është sistemi i kompjuterizuar, i autorizuar nga ministri përgjegjës për financat për regjistrimin, për llogari të zotëruesve, të nxjerrjeve, gjendjes së llogarisë, shërbimit dhe pagesës së titujve të shtetit dhe mbahet në formë të pacertifikuar apo jofizike.

Titujt të emetuar në formë regjistrimi në llogari janë titujt e emetuar dhe të mbajtur në mënyrë të kompjuterizuar apo regjistrimi kontabël në sistemin e autorizuar të sistemit të regjistrimit në llogari.

Titujt e shtetit, të emetuar në formën e regjistrimit në llogari, janë detyrime të shtetit dhe, si të tilla, nuk ndryshojnë nga titujt e shtetit, të emetuar në formë fizike, megjithëse emetimi, mbajtja e llogarisë dhe transaksionet e tyre, përfshirë edhe pagesa në maturim, realizohen në mënyrë elektronike. Pronari i regjistruar i titujve të shtetit, të emetuar në llogari, ka të drejta të plota mbi këta tituj.

Neni 18
Gjendja e titujve të shtetit, të emetuar në formë fizike

Certifikata apo titulli i certifikuar është titulli i autorizuar dhe i emetuar në formë të pandryshueshme fizike, që ka të shënuar emrin e zotëruesit në faqen e përparme të saj, apo përcaktime të tjera, në bazë të të cilave ajo është e pagueshme për zotëruesin.

Titujt e shtetit, të emetuar në certifikatë apo në formë fizike, janë detyrime të shtetit, të cilat identifikohen nëpërmjet serive të emetimit, numrit përkatës serial dhe vlerës nominale të tyre. Titujt e shtetit mund të emetohen në formë fizike, për të evidentuar, në mënyrë kolektive, një numër titujsh, që mbajnë të njëjtin përshkrim, por që emetohen në formën e regjistrimit në llogari. Kur titujt e emetuar më parë, në formë fizike, janë konvertuar në llogari, me kërkesë të pronarit ato nuk mund të rikonvertohen në formë fizike.

Neni 19 **Tregtueshmëria**

Titujt e shtetit janë të tregtueshëm ose të patregtueshëm, në varësi të kushteve të emetimit.

Neni 20 **E drejta për caktimin e kushteve**

1. Ministri përgjegjës për financat është i autorizuar të emetojë tituj të shtetit nëpërmjet këtyre formave:

a) me ankand, duke ushtruar, kur është e nevojshme, të drejtën për të hedhur poshtë njëren apo të gjitha kërkesat;

b) në bazë të marrëveshjeve dypalëshe apo shumëpalëshe.

2. Kushtet e emetimit të këtyre titujve shtetërorë janë:

a) me zbritje apo me normë fikse dhe/ose të ndryshueshme;

b) me emërtime të caktuara;

c) me emetim dhe datë maturimi të caktuar;

ç) me kufizim në sasinë e hedhur për shitje;

d) me datë të caktuar për pagimin e interesit;

dh) me thirrje, kur ekziston e drejta për të thirrur titujt e shtetit përpara datës së lajmëruar të maturimit.

Neni 21 **Derivativët**

1. Derivativët janë instrumente të derivuara nga kushtet e borxhit shtetëror të papaguar, ku përfshihen, ndër të tjera, edhe shkëmbime të normës së interesit apo shkëmbime të monedhës.

2. Ministri përgjegjës për financat, në përputhje me strategjinë e menaxhimit të borxhit, është i autorizuar të emetojë derivativë.

Neni 22 **Blerja e borxhit**

Ministri përgjegjës për financat, në përputhje me portofolin e borxhit dhe të situatës buxhetore, është i autorizuar të bëjë blerjen e borxhit apo të hyjë në transaksione të tjera në tregun sekondar.

Neni 23 **Dispozitat e zbatueshme**

Emetimi i titujve të shtetit bëhet në përputhje me ligjin në fuqi, që rregullon emetimin, transaksionet me titujt, si dhe subjektet e përfshira në këto transaksione.

Neni 24

Kufizime për pjesëmarrësit në tregun e titujve të shtetit

Pjesëmarrësit në tregun e titujve të shtetit nuk mund të bashkëpunojnë me një apo më shumë pjesëmarrës të tjerë, me qëllim që ta ndikojnë këtë treg, për sa u përket interesit, çmimit, sasisë së titujve të shtetit, që kanë të njëjtin përshkrim, si për ato të blera në ankand, ashtu edhe për ato të blera në tregun sekondar, si përbërje e portofolit, që mban secili nga pjesëmarrësit e tregut dhe të strategjisë së investimit të secilit pjesëmarrës në treg.

Pjesëmarrësit në tregun e titujve të shtetit nuk mund të marrin pjesë në çfarëdo lloj transaksioni, praktike apo veprimi, që përbën shkelje apo mashtrim ndaj pjesëmarrësve të tjerë në treg. Për këtë zbatohen sanksionet, administrative dhe penale, të parashikuara në ligjin, që rregullon emetimin, transaksionet me titujt dhe subjektet e përfshira në këto transaksione.

KREU IV

MARRËVESHJET PËR BORXHIN SHTETËROR DHE GARANCITË E HUAS

(ndryshuar titulli me ligjin nr. 181/2014, datë 24.12.2014)

Neni 25

Këshillimet për borxhin

Ministri përgjegjës për financat kërkon mendimin e Bankës së Shqipërisë për:

a) gjendjen e ndikimin e borxhit shtetëror mbi rezervat në monedhë të huaj, si dhe bilancin e pagesave;

b) shkëmbimin në kohën e duhur të informacionit për financimin e borxhit shtetëror të mëparshëm, atij aktual dhe të parashikuar;

c) shkëmbimin e informacionit për kurset e këmbimit valutor dhe pritjet e tij, për politikën monetare të Bankës së Shqipërisë, për politikën fiskale të ministrisë përgjegjëse për financat, në mënyrë që secila palë të jetë në gjendje të marrë parasysh, në mënyrë të përshtatshme, pikëpamjet e palës tjetër në procesin e planifikimit dhe të vendimmarrjes.

Neni 26

Procedurat e negocimit dhe miratimit të marrëveshjeve, instrumenteve për huat shtetërore dhe garancitë shtetërore të huas

(ndryshuar me ligjin nr. 181/2014, datë 24.12.2014; ndryshuar fjalia e dytë e paragrafit të parë, ndryshuar paragrafi i tretë, shtuar paragraf me ligjin nr. 92/2022, datë 22.12.2022)

Ministria përgjegjëse për financat mban kontakte zyrtare të drejtpërdrejta me kreditorët për sigurimin e financimeve nëpërmjet kredive. Në rastet kur merret hua nga kreditorë privatë, përzgjedhja e kreditorit bëhet nëpërmjet procedurave të përzgjedhjes, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ministri përgjegjës për financat negocion dhe vendos për kushtet thelbësore të kontratave të huas në emër të Republikës së Shqipërisë ose të Këshillit të Ministrave.

Ministri i Drejtësisë, me kërkesë të ministrit përgjegjës për financat, lëshon një opinion ligjor, sipas rastit, për marrëveshjet e huas ose të garancisë shtetërore që lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë ose të Këshillit të Ministrave, i cili vërteton zbatimin e rregullt të dispozitave ligjore në fuqi për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve përkatëse, ligjshmërinë e përmbajtjes së marrëveshjeve të nënshkruara, si dhe hyrjen në fuqi të tyre në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

Këshilli i Ministrave miraton procedurat për nënshkrimin, lëvrimin dhe raportimin e huave, të kredive dhe garancive, në emër të Këshillit të Ministrave ose të Republikës së Shqipërisë.

Ministri përgjegjës për financat ka të drejtë të lidhë kontrata të huamarrjes shtetërore apo të

emetojë instrumente borxhi të brendshëm dhe të jashtëm për sa kohë respektohen kushtet e përcaktuara në ligjin për buxhetin vjetor përkatës. Ministri përgjegjës për financat nuk mund të lidhë kontrata të huamarrjes shtetërore apo të emetojë instrumente borxhi të brendshëm dhe të jashtëm kur tejkalohen kufijtë e huamarrjes, të përcaktuar në ligjin për buxhetin vjetor përkatës. Në rast se lind nevoja të tejkalohen kufizimet e ligjit për buxhetin vjetor, miratimi i tyre bëhet vetëm nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Në marrëveshjet që do të lidhen nga ministri përgjegjës për financat për realizimin e huamarrjes në tregjet ndërkombëtare lejohen parashikimet e kushtëzuara për heqjen dorë nga imuniteti. Mbajtësit jorezidentë të instrumenteve të borxhit të marrë në tregjet ndërkombëtare, qofshin persona fizikë jorezidentë në Shqipëri apo entitete jorezidente pa një seli të përhershme në Shqipëri, përfshirë menaxherët bashkëdrejtues, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat në Shqipëri për të gjitha transaksionet dhe veprimtaritë që lidhen me emetimin, mbajtjen, ruajtjen e tregtimin e instrumenteve të borxhit, si dhe nga ndonjë tatim indirekt apo taksë tjetër e aplikueshme në Republikën e Shqipërisë.

Neni 27

Huamarrja dhe garancitë shtetërore të huas me anë të marrëveshjeve ndërkombëtare

(ndryshuar me ligjin nr. 181/2014, datë 24.12.2014)

Për qëllimet e këtij ligji, marrëveshje ndër-kombëtare për huat shtetërore dhe garancitë shtetërore të huas konsiderohen ato marrëveshje që lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë ose Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, nga ministri përgjegjës për financat, me shtete ose organizata ndërkombëtare publike.

Procedurat e negociimit, nënshkrimit, miratimit dhe ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare për huat shtetërore dhe garancitë shtetërore të huas kryhen sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

Ministri i Drejtësisë, me kërkesë të ministrit përgjegjës për financat, lëshon një opinion ligjor, i cili vërteton se janë zbatuar të gjitha dispozitat ligjore në fuqi, se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, në kuadër të marrëveshjes dhe se marrëveshjet janë të ligjshme e mund të hyjnë në zbatim me fuqi të plotë ligjore.

Neni 28

Përparësia e së drejtës ndërkombëtare

Në rast se kushtet dhe afatet e marrëveshjeve, të traktateve apo konventave ndërkombëtare për përdorimin, shërbimin dhe shlyerjen e borxhit shtetëror dhe të garancive shtetërore të huasë bien në kundërshtim me cilëndo dispozitë të këtij ligji apo me dispozita të ligjeve të tjera, parashikimet, kushtet dhe afatet e marrëveshjeve, të traktateve apo konventave ndërkombëtare zbatohen me përparësi.

Neni 29

Depozitimi i fondeve të huave shtetërore

(shtuar fjalë në fund të fjalisë së parë me ligjin nr. 92/2022, datë 22.12.2022)

Të gjitha fondet e përfuara nga huatë shtetërore depozitohen në Bankën e Shqipërisë, në një nënllogar të veçantë të ministrisë përgjegjëse për financat përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në marrëveshjen përkatëse të huas. Këto fonde përdoren sipas dispozitave ligjore në fuqi apo sipas kushteve dhe afateve të marrëveshjes, në bazë të së cilës janë marrë në dorëzim.

Neni 30

Huadhënia e të ardhurave të borxhit shtetëror

(ndryshuar titulli me ligjin nr. 181/2014, datë 24.12.2014; shtuar dy paragrafë pas paragrafit të tretë me ligjin nr. 92/2022, datë 22.12.2022)

Ministri përgjegjës për financat, kur e lejojnë kushtet e marrëveshjeve, nga të cilat rrjedh një borxh shtetëror, autorizohet të japë hua nga fondet që përbëjnë të ardhura të borxhit shtetëror, për huamarrësit, përfshirë këtu edhe institucionet financiare dhe pushtetin vendor, me veprimtari kryesore brenda Republikës së Shqipërisë, në mënyrë që këta të fundit të mundësojnë financimin e projekteve të investimit, importit apo të veprimtarive të tjera.

Procedurat për huazimin e fondeve dokumentohen me shkrim, nëpërmjet marrëveshjeve të nënhuasë, ndërmjet ministrit përgjegjës për financat dhe huamarrësit.

Është përgjegjësi ligjore e huamarrësve, të cilët kanë marrë fonde, sipas paragrafit të parë të këtij neni, që t'i kthejnë fondet e marra hua në përputhje me marrëveshjet e nënhuave dhe të paraqesin raporte për gjendjen e huasë dhe përdorimin e saj, sipas kërkesave të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për financat.

Në rast se huamarrësit nuk shlyejnë detyrimet e krijuara në kuadër të këtyre marrëveshjeve, ministria përgjegjëse për financat nëpërmjet institucionit të caktuar me ligj për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive, me anë të një urdhri me shkrim kërkon bllokimin e llogarive dhe sekuestrimin e shumës në vlerën e detyrimit të papaguar nga huamarrësi kundrejt ministrisë përgjegjëse për financat dhe ndjek shlyerjen e plotë të detyrimit.

Urdhri i nxjerrë sipas paragrafit të katërt të këtij neni përbën titull ekzekutiv sipas shkronjës "e" të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile dhe ngarkohet zyra përmbartimore për ekzekutimin e tij.

Huamarrësi, që ka marrë fonde sipas paragrafit të parë të këtij neni, detyrohet që, për çdo humbje financiare që ndodh në transaksionet e nënhuasë, të vërë në dijeni ministrin përgjegjës për financat me të dhëna të qarta dhe bindëse se ka ushtruar mbikëqyrje të përshtatshme për të mënjanuar humbjen. Ministri është i autorizuar të ndërmarrë çdo hap tjetër lehtësues ligjor për mbledhjen e të ardhurave.

Ministri përgjegjës për financat, sipas gjykimit të tij, mund t'u kërkojë huamarrësve, të cilëve u janë dhënë fonde në përdorim, sipas paragrafit të parë të këtij neni, të paguajnë principalin e huasë, interesin, komisionet dhe të gjitha detyrimet e tjera, që rrjedhin nga marrëveshja e nënhuasë, në monedhën e vendit apo në monedha të tjera, të ndryshme nga monedha kombëtare.

KREU V

KËSHILLTARËT, AGJENTËT FISKALË DHE NDËRMJE-TËSIT FINANCIARË TË BORXHIT SHTETËROR

(ndryshuar titulli me ligjin nr. 181/2014, datë 24.12.2014)

Neni 31

Emërimi i këshilltarëve, agjentëve fiskalë dhe ndërmjetësve financiarë të borxhit

(ndryshuar titulli dhe paragrafi i parë me ligjin nr. 181/2014, datë 24.12.2014)

Ministri përgjegjës për financat emëron këshilltarët, agjentët fiskalë dhe ndërmjetësit financiarë të borxhit shtetëror. Për qëllim të këtij neni, në përzgjedhjen e këshilltarëve, agjentëve fiskalë dhe ndërmjetësve të borxhit shtetëror nuk zbatohen rregullat e prokurimit publik. Kushtet dhe procedurat për emërimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Agjenti fiskal, në përputhje me funksionet, ka këto kompetenca:

a) zhvillon ankandet e titujve të shtetit dhe, lidhur me këto të fundit, publikon njoftimet mbi sasinë e ofruar nga ministria përgjegjëse për financat, formularët dhe udhëzimet për të interesuarit, si dhe informacion për rezultatet e ankandit;

b) krijon dhe mban një sistem regjistrimi në llogari për titujt e shtetit, i cili regjistron

emetimin, transfertat, transaksionet, si dhe pagesën e titujve të emetuar në formën e regjistrimit në llogari.

Ky sistem duhet të pasqyrojë me saktësi pronësinë dhe gjendjen e titujve, në përputhje me marrëveshjet e lidhura me agjentin fiskal dhe dispozitat ligjore;

c) mban stokun e titujve të shtetit dhe administron emetimin e tyre, në rast se këto tituj do të emetohen në formë fizike, duke mbajtur të dhëna të sakta për këtë emetim;

ç) mbështet krijimin e tregut sekondar të titujve të shtetit, duke përmirësuar mundësitë e përdorimit të sistemit të regjistrimit në llogari, nëpërmjet institucioneve financiare, që mbajnë llogaritë e pagesave në bankë;

d) administron dhe bashkërendon sistemin e regjistrimit në llogari me sistemin e pagesave, që bankat kanë për institucionet, në mënyrë që t'u mundësojë personave që tregtojnë tituj të shtetit krahasimin e dërgesave me pagesat brenda këtij sistemi;

dh) mban, në emër të ministrisë përgjegjëse për financat, llogarinë e unifikuar të thesarit, në mënyrë që paratë e depozituara ose të tërhequra, për titujt e shtetit, të emetuar ose të paguar për interesin dhe principalin e tyre, të realizohen në kohën e duhur, në çastin e emetimit dhe të maturimit të tyre;

e) ofron shërbime të tjera, përfshirë vlerësimin, sipas kërkesës, të gjendjes financiare të institucioneve huadhënëse, që marrin pjesë në programet e garancive shtetërore të huave apo dhe në çështje të tjera, të zgjedhjes së pjesëmarrësve në tregun primar të titujve të shtetit.

KREU VI RREGULLIMET NË LLOGARI

Neni 32 **Rregullimet në llogari**

Ministri përgjegjës për financat bën rregullimet në llogari për humbjen, vjedhjen, shkatërrimin apo dëmtimin e titujve të shtetit në qarkullim, të emetuar në formë fizike, me kusht që titujt të jenë të identifikuar me përshkrim, numër serie dhe që ministrisë t'i dorëzohet një kërkesë e plotë për rregullim nga pala e interesuar, në përputhje me rregulloret në fuqi.

Neni 33 **Pagesa e dyfishtë**

Kur zbatimi i rregullimit në llogari, në përputhje me nenin 31 të këtij ligji, është i nevojshëm, por shkakton realizimin e një pagese të dyfishtë apo të dytë për titujt në fjalë, ministria përgjegjës për financat mund të kompensojë humbjet e shkaktuara, duke i trajtuar si shpenzime të ndryshme, të realizuara në procesin e administrimit të borxhit shtetëror.

KREU VII GARANCITË SHTETËRORE TË HUASË

Neni 34 **Natyrë e garancisë shtetërore të huasë** *(ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 92/2022, datë 22.12.2022)*

Garancia shtetërore e huasë nuk përbën detyrim të drejtpërdrejtë për shtetin, por përfaqëson një detyrim të mundshëm të tij. Ky detyrim kthehet në detyrim të drejtpërdrejtë në rastin kur përfituesi i drejtpërdrejtë i huasë nuk ka arritur të paguajë, tërësisht apo pjesërisht, huanë e garantuar, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë.

Garancia shtetërore e huas konvertohet në borxh shtetëror nëse pagesa apo pagesat e

papaguara për huan për të cilën është dhënë garancia, nuk janë bërë në përputhje me kushtet dhe afatet e huas, duke shkaktuar në këtë mënyrë mospërbushjen e detyrimit të huamarrësit.

Neni 35

Sigurimi i garancisë shtetërore të huasë

(shtuar paragraf pas paragrafit të dytë me ligjin nr. 92/2022, datë 22.12.2022)

Në rast se emetimi i garancisë shtetërore të huasë është autorizuar në bazë të ligjeve të tjera, procedurat e përcaktuara për emetimin e këtyre huave vazhdojnë të zbatohen, me kusht që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të gjitha kërkesat për hua, të arkivuara në përputhje me ligjet e mëparshme, t'u nënshtrohen një rishikimi përfundimtar dhe miratimi nga ministri përgjegjës për financat. Ministrinë e tjera dhe autoritetet përfaqësuese të shtetit, që deri para hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë qenë të autorizuar të japin garanci shtetërore të huasë, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të dorëzojnë në ministrinë përgjegjëse për financat një informacion të plotë për të gjitha garancitë e papaguara, të emetuara.

Çdo huamarrës, që kërkon marrjen e një garancie shtetërore të huasë, në bazë të këtij ligji, paraqet një kërkesë me shkrim, e cila shoqërohet me dokumentacionin ekonomik dhe financiar, për t'i mundësuar ministrit përgjegjës për financat të vlerësojë kushtet financiare dhe aftësinë e pagimit nga huamarrësi.

Në rastet e skemave të veçanta të garancive, kërkesa me shkrim do t'u paraqitet institucioneve huadhënëse të përfshira në skemë, të cilat vlerësojnë kushtet financiare dhe aftësinë e pagimit nga huamarrësi.

Neni 36

Shqyrtimi dhe analiza e garancisë

(shtuar paragraf me ligjin nr. 92/2022, datë 22.12.2022)

Kur dokumentacioni mbështetës i kërkesës për një garanci shtetërore të huasë nuk është i plotë, kërkesa, së bashku me dokumentacionin kthehen për t'u plotësuar. Kur dokumentacioni është i plotë, Ministri përgjegjës për financat, në bazë të analizës ekonomiko-financiare të materialeve, është i detyruar që, brenda gjashtëdhjetë ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, të shpallë vendimin për dhënien e garancisë.

Në rastet e skemave të veçanta të garancive, institucionet e caktuara për dhënien e huas, sipas skemave të veçanta të garancive, shqyrtojnë dhe marrin vendimin në lidhje me kërkesat e depozituara pranë tyre në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, që ka miratuar skemën përkatëse të garancisë.

Neni 37

Vlerësimi i riskut

Analiza ekonomiko-financiare, e përmendur në nenin 36 të këtij ligji, përfshin një përcaktim të riskut që merr përsipër shteti, në rast se jepet garancia. Ministria përgjegjëse për financat mund të kërkojë asistencën e Bankës së Shqipërisë, për të përcaktuar dhe vlerësuar riskun.

Në rastin e garancive shtetërore të huasë, të dhëna në monedhë të huaj, informacioni mbi sasinë e riskut vlerësohet në monedhën kombëtare, sipas kursit të këmbimit të monedhës apo monedhave të huaja, në të cilën/cilat do të bëhet pagesa e garancisë.

Neni 38

Dhënia e garancisë shtetërore të huas

(ndryshuar me ligjin nr. 92/2022, datë 22.12.2022)

1. Ministri përgjegjës për financat, në emër të Republikës së Shqipërisë ose Këshillit të Ministrave, miraton dhënien e garancisë shtetërore të huas pasi shqyrton dokumentet e mëposhtme:

- a) projekt marrëveshjen e huas ndërmjet institucionit huadhënës dhe huamarrësit;
- b) projekt marrëveshjen e garancisë ndërmjet institucionit huadhënës dhe shtetit;
- c) projekt marrëveshjen e mirëkuptimit ndërmjet huamarrësit dhe shtetit.

2. Në rastin e skemave të veçanta të garancive, të cilat menaxhohen nga institucioni i caktuar me ligj për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive, ministri përgjegjës për financat, në emër të Republikës së Shqipërisë ose Këshillit të Ministrave, miraton:

- a) termat kryesorë të huas ndërmjet institucionit huadhënës dhe huamarrësit;
- b) projekt marrëveshjen e garancisë ndërmjet institucionit huadhënës dhe shtetit;
- c) projekt marrëveshjen tip të mirëkuptimit që do të nënshkruhet nga huamarrësi.

3. Përpara nënshkrimit të marrëveshjes së garancisë, Këshilli i Ministrave vendos:

- a) miratimin për dhënien e garancisë në rastet e pikës 1 të këtij neni; ose
- b) miratimin për skemën e veçantë të garancive në rastet e pikës 2 të këtij neni.

Neni 39

Dokumentacioni i garancisë shtetërore të huas

(ndryshuar me ligjin nr. 92/2022, datë 22.12.2022)

Ministria përgjegjëse për financat është e detyruar të ruajë të gjitha marrëveshjet e huas, marrëveshjet e garancisë dhe marrëveshjet e mirëkuptimit, të miratuara në bazë të këtij ligji. Në rastin e skemave të veçanta të garancisë, marrëveshjet e huas dhe mirëkuptimit do të ruhen nga institucioni i caktuar me ligj për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive.

Ministria përgjegjëse për financat ka detyrim ligjor të marrë në dorëzim dhe të ruajë të gjitha dokumentet që ndodhen në ministritë dhe institucionet shtetërore, në bazë të të cilave janë dhënë garancitë shtetërore të huas, huat e të cilave janë ende të papaguara.

Ministria përgjegjëse për financat mban të dhëna për garancitë shtetërore të huas në regjistrin e garancive shtetërore të huas në përputhje me këtë ligj. Çdo institucion tjetër, i caktuar me ligj për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive, raporton rregullisht në ministrinë përgjegjëse për financat të dhënat për garancitë që menaxhon. Përmbajtja dhe frekuenca e raportimit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.

Neni 40

Mbikëqyrja nga ministria përgjegjëse për financat

Ministria përgjegjëse për financat kryen mbikëqyrjen e kushteve financiare të të gjithë huamarrësve, që kanë marrë garanci shtetërore të huasë. Ministria përgjegjëse për financat u kërkon huamarrësve informacionin e nevojshëm për realizimin e kësaj mbikëqyrjeje.

Neni 41

Përfundimi i garancisë shtetërore të huasë

1. Garancia shtetërore e huasë përfundon kur:

- a) huaja, për të cilën është dhënë garancia, është shlyer tërësisht nga huamarrësi;
- b) afati i garancisë, siç specifikohet në marrëveshjen e garancisë, ka kaluar;
- c) pagesa i është bërë institucionit huadhënës, në përputhje me afatet e garancisë.

2. Ministri përgjegjës për financat dokumenton përfundimin e garancisë.

Neni 42

Pagesa për një garanci shtetërore të huas

(ndryshuar me ligjin nr. 92/2022, datë 22.12.2022)

Kur huamarrësi nuk ka mundësi të kryejë pagesën/pagesat në përputhje me kushtet dhe afatet e marrëveshjes së huas, të përcaktuara për këtë qëllim, njofton menjëherë ministrinë përgjegjëse për financat. Pas këtij njoftimi, ministria përgjegjëse për financat verifikon paaftësinë paguese të huamarrësit sipas paragrafit të katërt të këtij neni. Për kryerjen e këtij verifikimi, ministria përgjegjëse për financat është e autorizuar që nëpërmjet institucionit të caktuar me ligj për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive, të kërkojë dhe të marrë nga bankat informacion mbi gjendjen e llogarive bankare të subjekteve përfituese të garancisë.

Kërkesa për pagesë mund t'i vijë ministrisë përgjegjëse për financat edhe nga institucioni huadhënës.

Në zbatim të detyrimeve që lindin nga marrëveshja e garancisë, me marrjen e njoftimit/kërkesës të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni, ministri përgjegjës për financat autorizon kryerjen e pagesës në përputhje me përcaktimet e marrëveshjeve të huas dhe garancisë. Pagesa kryhet përpara dhe pavarësisht rezultatit të verifikimit të aftësisë paguese të huamarrësve.

Ministria përgjegjëse për financat, nëpërmjet institucionit të caktuar me ligj për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive, kryen verifikimin e aftësisë paguese të huamarrësve. Nëse nga ky verifikim rezulton se ka mundësi pagese dhe në rast se pagesa e detyrimit është kryer nga ministria përgjegjëse për financat, institucioni i caktuar me ligj për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive, me anë të një urdhri me shkrim kërkon bllokimin e llogarive dhe sekuestrimin e kundërvlerës që ministria përgjegjëse për financat ka paguar dhe ndjek shlyerjen e plotë të detyrimit.

Urdhri i nxjerrë sipas paragrafit të katërt të këtij neni përbën titull ekzekutiv.

Në rastin e skemave të veçanta të garancisë, kërkesa për pagesë trajtohet nga institucioni i caktuar me ligj për administrimin e skemave të veçanta të garancisë, i cili kryen verifikimin e përputhshmërisë së kërkesës për pagesë me kushtet e përcaktuara në marrëveshjen e huas. Institucioni i caktuar me ligj për administrimin e skemave të veçanta të garancisë përcjell kërkesën për pagesë pranë ministrit përgjegjës për financat jo më vonë se 20 ditë pune.

Ministri përgjegjës për financat autorizon transfertën e pagesës ose pagesave për institucionin huadhënës brenda 15 ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit.

Neni 43

Kthimi i garancisë shtetërore të huasë

(zëvendësuar fjalë në paragrafin e parë, ndryshuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 92/2022, datë 22.12.2022)

Me kryerjen e pagesës ndaj institucionit huadhënës, ministri përgjegjës për financat merr në dorëzim të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore, që zotëronte institucioni huadhënës ndaj huamarrësit, sipas përcaktimeve të marrëveshjes së huasë, në masën e çdo pagese të bërë në kuadër të garancisë së dhënë. Këto të drejta dhe mjete ligjore i kalojnë ministri përgjegjës për financat, së bashku me të drejtat dhe mjetet ligjore që ai ka në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit.

Huamarrësi, në zbatim të këtij ligji dhe të marrëveshjes së mirëkuptimit, është i detyruar t'i kthejë Ministrisë përgjegjëse për financat shumën që kjo e fundit i ka paguar huadhënësit, në kuadër të garancisë shtetërore të huasë.

Ministri përgjegjës për financat, nëpërmjet institucionit të caktuar me ligj për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive, ndërmerr të gjitha masat e paracaktuara në këtë ligj, në ligje të tjera në fuqi dhe në marrëveshjen e mirëkuptimit, për rikuperimin e garancisë së përftuar nga

huamarrësi për çdo pagesë të bërë sipas garancisë, duke përfshirë edhe kostot që lidhen me të, referuar të gjitha garancive shtetërore të lëshuara sipas objektit të këtij ligji, si dhe garancive të tjera të lëshuara para hyrjes në fuqi të tij.

KREU VIII ADMINISTRIMI I TË DHËNAVE

Neni 44

Centralizimi i të dhënave

Ministri përgjegjës për financat mbledh dhe administron të dhënat e plota dhe të sakta të të gjitha detyrimeve, që kanë të bëjnë me borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë. Të gjitha ministritë apo institucionet e tjera qendrore, të cilat kanë të dhëna të tilla, marrin masa për kalimin e tyre në Ministrinë përgjegjëse për financat.

Neni 45

Regjistrat shtetërorë të të dhënave

Për administrimin e të dhënave për borxhin shtetëror dhe për garancitë shtetërore të huasë, Ministria përgjegjëse për financat krijon dy regjistra:

- a) regjistrin e borxhit shtetëror;
- b) regjistrin e garancive shtetërore të huasë.

Neni 46

Regjistri i borxhit shtetëror

(hequr fjalë në paragrafin e dytë me ligjin nr. 92/2022, datë 22.12.2022)

Regjistri i borxhit shtetëror përmban të dhëna për borxhin shtetëror, të emetuar në formën e titujve të shtetit dhe borxhin në formën e marrëveshjeve të huasë. Regjistri i borxhit shtetëror mund të përmbajë edhe kategori të tjera të dhënash, sipas përcaktimit të bërë në udhëzimin e miratuar nga ministri përgjegjës për financat.

Ky regjister përmban edhe informacion për detyrimet ekzistuese, në monedhën vendase apo monedha të huaja.

Regjistri i borxhit shtetëror përditësohet në mënyrë të vazhdueshme nga ministria përgjegjëse për financat dhe botohet një herë në tre muaj.

Neni 47

Regjistri i garancive shtetërore të huasë

(hequr fjalë në paragrafin e dytë, shtuar fjali në paragrafin e tretë me ligjin nr. 92/2022, datë 22.12.2022)

Regjistri i garancive shtetërore të huasë përmban informacion, sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e miratuar nga ministri përgjegjës për financat.

Në këtë informacion përfshihen të dhënat e identifikimit të secilës garanci huaje, sipas huamarrësit, institucionit huadhënës, shumës së huasë, monedhës dhe gjendjes së huasë.

Huamarrësi depoziton pranë ministrisë përgjegjëse për financat, në datën 15 të çdo muaji, informacionin e nevojshëm për gjendjen dhe lëvizjen e fondeve të huasë së garantuar. Institucioni i caktuar me ligj për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive raporton rregullisht në ministrinë përgjegjëse për financat të dhënat e regjistrit për garancitë që ajo menaxhon, sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për financat.

Regjistri i garancive shtetërore të huasë përditësohet, në mënyrë të vazhdueshme, nga ministria përgjegjëse për financat dhe botohet një herë në tre muaj.

KREU IX DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 48

Fusha e veprimit të ligjit

Dispozitat e këtij ligji zbatohen për shumën e përgjithshme të borxhit shtetëror të emetuar, si dhe për të gjitha garancitë shtetërore të huasë, të kontraktuara nga ministria përgjegjëse për financat, në përputhje me ligjet që kanë qenë në fuqi përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Borxhi i parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni vlerësohet borxh shtetëror dhe, si i tillë, përbën detyrim ligjor të ekzekutueshëm nga ministria përgjegjëse për financat dhe gëzon të njëjtin trajtim me borxhin dhe me garancitë shtetërore të huasë, që do të miratohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 49

Informacioni për garancitë shtetërore të huasë të dhëna para hyrjes në fuqi të ligjit

Ministri përgjegjës për financat u kërkon të gjitha ministrive dhe organeve qeverisëse të shtetit dhe institucioneve të tjera, që kanë dhënë më parë garanci shtetërore të huasë, të paraqesin, jo më vonë se tridhjetë ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të dhënat për të gjitha garancitë e papaguara, përfshirë edhe kërkesat për garanci që janë në shqyrtim. Kopjet e marrëveshjeve të huasë, për të cilat janë dhënë garanci, dokumentacioni mbështetës dhe informacioni për gjendjen korrente të pagesave të huave të papaguara i dërgohen Ministrisë përgjegjëse për financat. Këto të dhëna regjistrohen në regjistrin e garancive shtetërore të huave.

Neni 50

Përfaqësimi i ministrit përgjegjës për financat

Secila dhe çdo referencë ndaj ministrit përgjegjës për financat në këtë ligj është referencë për çdonjërin, i cili është duke vepruar si ministri përgjegjës për financat dhe një referencë e tillë do të përfshijë çdo zyrtar në rolin e ministrit gjatë mungesës së tij. Veprimet e ndërmarra nga autoriteti në rolin e ministrit përgjegjës për financat do të vlerësohen të njëjta me veprimet e ndërmarra nga vetë ministri dhe nuk do të jetë i nevojshëm asnjë delegim formal i autoritetit.

Neni 51

Nxjerrja e akteve nënligjore (*shtuar fjali me ligjin nr. 92/2022, datë 22.12.2022*)

Ngarkohet ministri përgjegjës për financat të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5, 16, 17, 20, 21, 31, 39, 47 e 49 të këtij ligji. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 26 të këtij ligji.

Neni 52

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5180, datë 12.1.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**